

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANE

Nr.2441 AKTI

Nr.2799 Vendimi

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë prej :

Gjyqtar -Artan GJERMËNI (Kryetar-seance)

Gjyqtar -Arben MICKAJ (Anetar)

Gjyqtar - Albert MECA (Anetar)

Asistuar nga sekretare gjyqesore Ornela Balla,sot me datë 25.10.2018 mori në shqyrtim ne séance gjyqesore me dyer te hapura, me gjykim të shkurtuar,çështjen penale Nr.2441 Akti,që i përket;

KERKUESE: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurore Suela Salavaci.

KUNDËR TË PANDEHURËVE:

1.A.. Z. – e bija e N..dhe e S.. ,e dtl.25.04.19...,lindur dhe banuese ne Tirane ,me adrese rruga “...”,pall.Nr....,shk.....ap....,me arsim te mesem, me gjendje gjyqësore e padënuar me pare, me shtetësi dhe kombësi shqiptare,ne mungese, perfaqesuar nga avokati Ardian Leka - me Nr.444 Licence dhe Nipt K1614166P,Anetare i Dhomes se Avokatise Tirane,i zgjedhur nga e pandehura.

AKUZUAR:Për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” te parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

2.G.. R. -i biri i N. dhe i S., i datëlindjes 23.12.19..., lindur dhe banues ne Tirane,me adrese :rruga “...” ,pall. nr....,shk....,ap. nr.... ,me arsim te mesem, me gjendje gjyqësore i padënuar me pare, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, ne mungese , perfaqesuar nga avokati Ardian Leka- me Nr.444 Licence dhe Nipt K1614166P,Anetare i Dhomes se Avokatise Tirane,i zgjedhur nga i pandehuri.

I AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

3. G. R. -i biri i N. dhe i S., i datëlindjes 26.05.19.., lindur dhe banues në Tiranë, me adresë rruga “...” ,pall. nr....,shk....,ap. nr.... ,me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore të padënuar me parë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, në mungesë ,perfaqësuar nga avokati Ardian Leka- me Nr.444 Licence dhe Nipt K1614166P,Anetare i Dhomes së Avokatise Tiranë,i zgjedhur nga i pandehuri.

I AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

VIKTIMAT :Trashigimtarët ligjorë – A. K. ,K. K. ,L. S.,S. K.,perfaqësuar nga avokatet Sokol Mengjesi dhe Klodjan Skenderaj.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, mori e administroi provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Prokurore Suela Salavaci kërkoi:

-Deklarimin fajtorë të të pandehures A.Z.,e akuzuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” e parashikuar nga neni 287/2(ligji i kohës) i K.Penal dhe denimin e saj me 5 (pese)vjet burgim.

-Deklarimin fajtorë të të pandehurit G..R.,i akuzuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” e parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (ligji i kohës)dhe denimin e tij me 5 (pese)vjet burgim.

-Deklarimin fajtorë të të pandehurit G. R.,i akuzuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” e parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (ligji i kohës)dhe denimin e tij me 5 (pese)vjet burgim.

-I sugjerojme gjykatës aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale “Për gjykimin e shkurtuar”.

-Në bazë të nenit 59,60 të K.Penal ,pezullimin e ekzekutimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepra tjeter penale po aq të rënda apo më të rënda dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

-Shpenzimet gjyqësore në fazën e hetimit të ngarkohen të pandehureve.

Avokati Ardian Leka:

-Bazuar në dispozitat e neneve 388/1/b,389 e vijues të K.Pr.Penale i kërkojme gjykatës deklarimin e pafajshëm të të pandehureve A.Z. ,G.R.dhe G. R. sepse fakti nuk përben veprën penale.

-Heqjen e sekuestros preventive ,urdheruar me vendimin Nr.2293 Regj.Them date 13.10.2017,per llogarite bankare .

Avokati Klodjan Skenderaj:

-Deklarimin fajtores te te pandehureve G. R. ,G.R. ,A. Z. per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale te parashikuar nga neni 287/2 te K.Penal.

-Ruajtjen e sendeve te sekuestruara ne shumen monetare sipas vendimit te sekuestros preventive Nr.2293 date 13.10.2017 dri ne zgjidhjen perfundimtare prane gjykates kompetente.

-Une kam paraqitur ne date 11.10.2018 si perfaqesues i viktimes kerkesen per sigurim padie ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane (Dhoma Civile).

V Ë R E N:

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nga ana e organit të akuzës është paraqitur kërkesa për gjykim kundër të pandehurëve A. Z.,G. R. dhe G. R. të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar në neni 287/2 i K.Penal.

Nga aktet e seances paraprake rezulton se te pandehurit nepermjet perfaqesuesit te tyre kane kerkuar gjykim te shkurtuar, duke pranuar qe gjykimi te zhvillohet ne gjendjen qe jane aktet ne fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim, ndaj dhe gjykata bazuar në nenet 405 të K.Pr.Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të proçedojë me gjykim të shkurtuar për te pandehurit, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjëndjen që janë paraqitur aktet nga organi i prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenit 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilat ndodhen këto akte.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar.Në këtë fashikull bazohen diskutimet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit. Nga aktet rezultoi se perfaqesuesi i viktimave ne hetim dhe perfaqesuesi i avokatit te shtetit ne séance parapraka kane paraqitur padi civile

Me vendimin e ndërmjetëm të datës 24.09.2018 kjo Gjykatë ndër të tjera vendosi :....Gjykata bazuar në nenin 405/9 të K.Pr.Penale ,duke qenë se pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, çmën se paditë civile të paraqitura pranë Gjykatës Civile dhe ardhur pranë kesaj gjykate ,për kompetencë dhe të paraqitura në séance paraprake ,nuk do të shqyrtohen nga kjo gjykate.

- Neni 405/9 të K.Pr.Penale nuk jep ndonjë definicion se çfarë duhet të bëhet me aktet e padive civile të cituara më lartë por në interpretim të nenit 62/3 të K.Pr.Penale ,kjo gjykate çmën se paditë civile duhet të dërgohen për vazhdimin e gjykimit pranë Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësorë Tiranë e në aktet e procedimit penal të mbahen fotokopje të tyre.

Rrethanat e çështjes.

Nga verifikimi në tërësi i akteve, rezulton se: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në kallezimin penal të paraqitur nga shtetasi G. M., në cilësinë e përfaqësuesit të trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënesit Sh. K., ka regjistruar procedimin penal Nr.9709 të vitit 2015, për veprën penale të “Pastrim i produkteve të vepres penale” , të parashikuar nga neni 287 i K.Penal. duke përdorur si mjete veprën penale të fallsifikimit.

Në vitin 1995, i pandehuri G. R., si trashëgimtarë ligjor i trashëgimlënesit N. R. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padinë me objekt njohje bashkëpronësie për një sipërfaqe 31.115 metra katror. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, i pandehuri, ka pretenduar se babai i tij N. R. ka pasur një pasuri para vitit 1944, një sipërfaqe toke prej 36 dynym dhe nga kjo sipërfaqe ka shitur 4885 metra. Për të vërtetuar pretendimin e tij, ai ka paraqitur në gjykatë një hartë e vërtetuar me origjinalin, sipas vërtetimit noterial nr.... prot, të datës 01.02.1994 dhe vërtetimin hipotekor të datës 13.11.1993. i cili tregon në mënyrë të qartë (një pjesërisht) sipërfaqen e pasurisë së trashëgimlënes N. R., dhe tregon veprimin e kryer në vitin 1940 me trashëgimlënesin Sh. K..Për pjesën me tepër të pretenduar palet në procesin civil kanë paraqitur akte origjinale, sic është harta origjinale e kohës me konturet e pasurisë.

Gjykata Civile e Shkallës së Parë Rrethit Gjyqësorë Tiranë ka caktuar një ekspert,(prezumohet që ka analizuar të gjitha shitjet edhe ato të Sh. K. që kanë paraqitur të pandehurit) i cili ka bërë këtë shënim në vijën e konturuar me sipërfaqe prej 34000 (34 dynym), ku janë bërë shitje të ndryshme. Si përfundim si vijë pronësie e pretenduar nga familja R., konturohet një sipërfaqe prej 29.556 metra katror.Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr...., të datës 30.05.1995, ka vendosur njohjen e bashkëpronësisë mbi një truall me sipërfaqe 26.757 m2 katror truall, që ndodhet në rrugën e ..., trashëgimtarëve të trashëgimlënesit N.R..

Pas këtij vendimi trashëgimtarët e trashëgmlenesit N. R., të pandehurit G. R., A.Z. dhe G. R. i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të pronave për kthimin e pronës së trashëgimlënësit të tyre. Me vendimin nr...., datë 17.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kombesimit të pronave ka vendosur të njohe e ti kthejë ish pronarit N. R. një truall të lirë me sipërfaqe të përgjithshme 26,757 metra katror.

Gjatë hetimit të çështjes janë marrë në Komisionin e Kthimit dhe Kompesimit të pronave si dhe Gjykatën e Shkalles së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë dokumentacioni i ndodhur në të dyja dosjet, si në Gjykatë ashtu dhe në Komisionin e Kthimit dhe Kompesimit të pronave, ku ndodhet vërtetimi hipotekor datë 13.11.1993.

Kopja e vërtetimit hipotekor datë 13.11.1993, e cila ndodhet në dosjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nuk është e njëjtë me kopjen e vërtetimit hipotekor që ndodhet në vendimin e gjykatës. Vërtetimi hipotekor i paraqitur në gjykatë (e sakta) nuk është e njejte me atë të paraqitur KKKPronave (jo e njejtë) pra të kjo e fundit mungon transkriptimi i fundit, që ka të bëjë edhe me vendimin nr.... datë 25.02.1958 të Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Tiranës në bazë të së cilit rregjistrohet në favor të shtetit, një ndërtesë në emer të shtetases S. R., pishinë dhe 500 metra katror truall (nga shteti është shtetëzuar shtëpia pishina dhe 500 metra katror). I pyetur në lidhje me faktet objekt hetimi shtetasi E.N., topografi që ka përgatitur planvendosjen e pronës që do të kthehej, ka shpjeguar se bazuar në hartën e paraqitur nga kerkuesit, bazuar edhe në vendimin e gjykatës, ka shkuar në vend për të bërë planvendosjen e pronës së pretenduar. Për të kryer verifikimin ai është shoqëruar nga të pandehurit G.R. dhe nga vëllai i tij. Në planvendosjen e pretenduar ai ka pasqyruar të gjitha shitjet që janë kryer në bazë të vërtetimit hipotekor që ndodhet në dosjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave.

Pasi prona e përfituar në bazë të vendimit të Komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave është regjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, trashëgimtarët Radovicka, dhe më pas me kontratën e shitblerjes nr...., datë 02.06.2011, një pjesë të kësaj sipërfaqe toke prej 6700 metra katror, nga prona e regjistruar në emer të tyre sipas vendimit të Komisionit dhe Kompesimit të Pronave ia është shitur Ambasadës të Republikës së Turqisë. Prona është shitur me vlerën 1000 euro për metër katror, në vlerën totale 6.700.000 (gjashtë milion e shtatëqind mijë) euro.

Trashëgimtarët e të ndjerit S. K., A. K., K.K., L. U.S., S. K. i janë drejtuar Gjykatës së Shkalles së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padi me objekt "Anulimin pjesërisht të vendimit nr...., datë 17.12.1995, të KKPP Tiranë për sasi i përket sipërfaqes së tokës prej 2000 m². Gjatë gjyqimit civil është kryer një akt ekspertimi dhe nga ekspertimi topografik është arritur në

konkluzionin se;.. sipërfaqja prej 2000 metra katror e blere nga shtetasi Sh. K.në vitin 1940, ndodhet brenda sipërfaqes së pronës prej 26.757. m²(qe eshte njohur me Vendim Gjyqesore Civil e kthyer nga K.K.K.Pronave) që familja R.ia ka shitur Ambasadës Turke. Gjatë gjykimit civil të paditurit (trashëgimtarët ligjore R.), kanë qënë dakort për anulimin pjesërisht të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, për sa i takon sipërfaqes 2000 metra katror, sipërfaqe te cilën babai i tyre ia ka shitur familjes K.. Palet ne gjykimin civil (te akuzuarit ne procesin penal objekte gjykimi) kane pretenduar se nuk kane patur dijeni per kete shitje te realizuar nga trashigimlensi. Gjykata Civile Tirane me vendimin nr date 13.7.2015. perfundimisht ka analluar vendimin e K.K.K.Pronave pjeserishte, per sa i perkete sipërfaqes prej 2000 m². Ne kete vendim civil midis te tjerash theksohet se....Vendimi i K.K.K.Pronave nr.... date 17.12,1995 I referohet ne pjesen sqaruese edhe vendimit date 30.5.1995, te Gjykates se Rrethit Tirane

Per organin e akuzes të pandehurit G. R., G. R. dhe A. Z. kanë përfituar në mënyrë të kundraligjshme shumen 2000 metra X 1000 Euro, e cila i korespondon shumës së përfituar nga shitja e 2000 metra katror që në fakt i takojnë trashëgimtarëve të trashëgmlenesit Sh. K..Shuma e përfituar nga shitja Ambasades Turke, pretendon akuza është produkt i veprës penale.

Këto rrethana u provuan me :

-Në teresi fashikullin e procedimit penal te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr.9709 e vitit 2015 gjithsej 293 flete + 4 volume .

-Dosja gjyqesore Nr.... Akti date 04.06.2018 e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,që ka te beje me kerkesen per dergimin e ceshtjes ne gjyq.

-Dosja gjyqesore Nr.... Vendimi date 26.07.2018 e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (Dhoma Civile).

II.Vlerësimi i Gjykatës.

1.Lidhur me përgjegjësinë penale të të pandehurve.

Mbi bazën e këtyre fakteve: Nga akuza u kërkua deklarimi fajtor i të pandehurve për kryerjen e vepres penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ” te parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal i K.Penal, dhe denimin e tyre ne masen e percaktuar ne pjesen hyrese të këtij vendimi, duke u parashtruar se me veprimet e tyre të kryera me dashje te pandehurit kane konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 287/2 te K.Penal.

Në permbajtjen e nenit 287 te K.Penal, sanksionohet se (Ligji penal i kohes se kryerjes se vepres penale).

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”

1. Pastrimi i produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet:

a. këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen ose zhdukjen e origjinës së paligjshme të pasurisë ose dhënien e ndihmës për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale;

b. fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera, që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale;

c. kryerjes së veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave;

ç. shfuqizuar;

d. këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike, për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.

dh. Përdorimit dhe investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve që janë produkte të veprave penale, denohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa kur ka sjellë pasojat të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet .

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në rastet kur personi që ka kryer veprën prej së cilës burojnë produktet e veprës penale, nuk mund të merret i pandehur, nuk mund të dënohet, ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose mungon njëri nga kushtet e procedimit penal për një vepër të tillë ...”

Sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Kjo kërkesë është parashikuar në nenin 388 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht: “1. Gjykata merr vendim pafajësie kur: a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston; b) fakti nuk përbën vepër penale; c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet; d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet; e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut

padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qënien e tyre.” Prandaj, konstatimi i elementeve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe praktike, sepse ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë.

Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

-Arsyetimi i Gjykates, argumentat juridike, interpretimi dispozitive penale, analiza e provave.

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria i akuzon të pandehurit për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale" te parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal (ligji i kohës në vitin 2011) ,pasi nga rrethanat e faktit rezulton se ata i kanë konsumuar të gjithë elementët objektiv e subjektiv të marrë së bashku, që kjo veper penale të konsiderohet e kryer. Duke qënë se veprimet janë shtrirë në kohë, Gjykata çmon te pasqyrojë të gjitha ndryshimet e bëra në nenin 287 të Kodit Penal. Kështu, me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të miratuar me Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 në nenin 287 të këtij Kodi nën titullin "Tjetërsimi i pasurisë" parashikohej shprehimisht se: "Tjetërsimi, transferimi, fshehja, zhdukja e natyrës, e burimit, e përkatësisë së pasurisë të vënë nga krimet, dënohen me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.". Kjo dispozitë ka qënë në fuqi deri më datë 27.07.2003 të Ligjit Nr. 9086, datë 19.06.2003, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 57 , datë 14 Korrik 2003, ku në nenin 8 të këtij ligji thuhet shprehimisht se: "Neni 287 ndryshohet si më poshtë: "Neni 287: Pastrimi i produkteve të veprës penale 1. Pastrimi i produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen ose zhdukjen e origjinës së paligjshme të pasurisë ose dhënien e ndihmës për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera, që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale; c) kryerjes së veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për

shmangien nga raportimi, sipas ligjit për pastrimin e parave; ç) fitimit, zotërimit ose përdorimit të pasurisë, kur dihet që është produkt i veprës penale; d) këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë. 2. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 800 mijë lekë deri në 8 milionë lekë, ndërsa kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 3 milionë lekë deri në 10 milionë lekë. 3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në rastet kur personi, që ka kryer veprën prej së cilës burojnë produktet e veprës penale, nuk mund të merret i pandehur, nuk mund të dënohet, ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose mungon njëri nga kushtet e procedimit penal për një vepër të tillë.". Me ligjin Nr. 9276 datë 16.9.2004, i cili ka hyrë në fuqi më datën 22.10.2004, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 69 datë 7 Tetor 2004, konkretisht në nenin 24 të këtij ligji thuhet shprehimisht se: "Neni 24 Në paragrafin e parë të nenit 287, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje: "dh) përdorimit dhe investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve, që janë produkte të veprave penale."Ndërkohë me ligjin Nr. 9686, datë 26.2.2007, i cili ka hyrë në fuqi më datë 31.03.2007 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, datë 16 Mars 2007, konkretisht në nenin 24 të këtij ligji thuhet shprehimisht se: "Në nenin 287 bëhen ndryshimet e mëposhtme: 1. Shkronja "a" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: "a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale;". 2. Shkronja "ç" shfuqizohet.". Gjithashtu, me ligjin Nr. 23, datë 01.03.2012, i cili ka hyrë në fuqi më datë 11.04.2012 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 26, datë 27 Mars 2012, konkretisht në nenin 37 të këtij ligji thuhet shprehimisht se: "Neni 287 ndryshohet si më poshtë: "Neni 287: Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes

publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në pesë milionë lekë. Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në tetë milionë lekë. E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim dhe me gjobë nga tre milionë gjer në dhjetë milionë lekë. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”. Po ashtu, me Ligjin Nr. 144/2013, i cili ka hyrë në fuqi më datën 05.06.2013, konkretisht në nenin 48 thuhet shprehimisht se: “Neni 48 Shfuqizime 1. Neni 79 shkronja “c”, nenet 114/a, 114/ b, 245/2 dhe 284/b shfuqizohen. 2. Në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 124/a, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 197/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331, pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet.”. Kjo bën që neni 287 që nga data 05.06.2013 e në vazhdim të ketë këtë përmbajtje: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave ; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë. Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në

bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana faktive objektive.”.

Në lidhje me objektin e veprës penale, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”. Vepra penale për të cilën akuzohen te pandehurit është parashikuar nga Kodi Penal në Pjesën e posacme të tij, në SEKSIONI III, “Vepra Penale Kundër Rendit dhe Sigurisë Publike”. Objekti i kësaj vepre penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale. Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Në lidhje me anën objektive (actus rea) të figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjen

rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, (ligji i kohës kryerjes së veprës penale) nga ana objektive kryhet nëpërmjet (për çështjen objekte gjykimi):

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera, në lidhje me pasurinë, është produkt i veprës penale.

Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t’i krijojë gjykatës bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.”. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. GJEDNJ, shprehet se: “Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”.

Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: “Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.”. Kur

vihet në dyshim kualifikimi i faktit (“akuzës”, “veprës penale” për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në bazë të këtij parimi pranohet se kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili sipas parimit të njohur in dubio pro reo, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.

Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se te pandehurit e kane konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale” parashikuar nga paragrafi nëniti 287 të Kodit Penal. Nuk provohet se te pandehurit kane perfituar pasurine prej 26.757 m2 ne vitin 1995 me vendim te K.K.K.Pronave me ane te kryerjes se vepres penale te fallsifikimit, dhe shitja e pasurise ne vitin 2011 ne favor te Ambasades te Shtetit te Turqise,nuk eshte bere me qellim pastrim produkte vepre penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se ta pandehurit pasurine ne perputhje me ligjin e kohes,e kane fituar me nje nga menytrat e fitimit te pronesis; Me vendimin nr...., datë 17.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të pronave ka vendosur të njohe e ti kthejë ish pronarit N.R.një truall të lirë me sipërfaqe të përgjithshme 26,757 metra katror.Ky vendim adminisrativ nuk rezulton qe te jete i fallsifikuar.Pretendimi i akuzes se ne permbatjen e akteve te K.K.K.Pronave te dorezuar nga te pandehurit kopja e vërtetimit hipotekor datë 13.11.1993, e cila ndodhet në dosjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nuk është e njëjtë me kopjen e vërtetimit hipotekor që ndodhet në vendimin e gjykatës, transkriptimi që ka të bëjë me familjen e shtetasit Sh. K. , nuk mirepritet nga ana e gjykares per te vertetuar faktin se te pandehurit kane fallsifikuar ate akte, pra vendimin e K.K.K.Pronave.Palet qe ne fillim te procesit per kthimin dhe kompesimin e pronave kane qene te paqarte per dokumentacionin e pasurise se lene trashegim, e ky ka qene shkaku qe atai jane drejtuar Gjykares Civile.Gjykata cmon se ne qofte se kjo qartesi do te ekzistonte, ata (te pandehurit) skishin pse ti drejtoheshin Gjykares Civile por drejteperdrejte K.K.K.Pronave.Determinante për këtë gjykatë në këte logjike është fakti që të pandehurit në Gjykatën Civile kanë paraqitur dokumente të verteta në forme e përmbajtje(edhe akuza e pranon).Gjykata cmon se nuk eshte në tagrin e organit të akuzes qe të cmoje provat qe kane cuar K.K.K.Pronave ne ate vendimmarrje.Eshte gjykata ajo qe konstaton ligjshmerine a paligjshmerine e vendimit te K.K.K.Pronave te vitin 1995. Ne ceshtjen objekte gjykimi Avokatit iShtetit ka paraqitur kerkime qe nga ana kesaj gjykate iu derguan per kompetence seksionit Civile te Gjykares se Shkalles se Pare te Rrethit

Gjyqesore Tirane. Akuza anashkalon faktin se ai komision ka marre per baze ne njohjen e kthimin fizik te siperfaqes prej 26.675 m2 edhe Vendimin e Gjykates Civile ,e qe sipas akte ekspertimi jane zbritur edhe shitjet e kryera.

Trashëgimtarët e të ndjerit Sh.K.,A. K., K. K., L. U. Sch., S.K. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padi me objekt: “Anulimin pjesërisht të vendimit nr...., datë 17.12.1995, të KKPP Tiranë përsa i përket sipërfaqes së tokës prej 2000 m2. Gjatë gjykimit është kryer një akt ekspertimi dhe nga ekspertimi topografik është arritur në konkluzionin se siperfaqja prej 2000 metra katror e blere nga shtetasi Sh. K. në vitin 1940, ndodhet brenda siperfaqes së pronës pre 26.675. m2 (qe gjykata civile ka njohur para vendimarrjes se K.K.K.Pronave) , e qe nga kjo siperfaqe 2000 m2 te saj, familja R. ia ka shitur Ambasadës Turke.

Gjatë gjykimit civil të paditurit (trashëgimtarët Radovicka), kanë qënë dakort për anulimin pjesërisht të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, për sa i takon sipërfaqes 2000 metra katror, siperfaqe te cilën babai i tyre ia ka shitur familjes K.. Palet ne gjykimin civil (te akuzuarit ne procesin penal objekte gjykimi) kane pretenduar se nuk kane patur dijeni per kete shitje te realizuar nga trashigimlensi.

Pra sa me siper ,gjykata cmon se pasuria e fituar prej 26675 m2 me vendim te K.K.Pronave ne favor të të pandehurve si trashegimtare ligjore të trashegimlensesit N.R. nuk eshte i fallsifikuar.Fakti që për një pjese të kësaj pasurie kanë pretenduar trashegimtarete ligjore teë trashegimlensesit Sh. K. nuk tregon se vendimi i K.K.K.Pronave eshte i fallsifikuar. Procesi i kerkimit te pasurise trashegimore eshte nje proces civil ,dhe per ceshtjen objekt gjykimi ai ka perfunduar, dhe të pandehurit me marrjen dijeni të ketij fakti dhe paraqitjes së provave të plota në gjykimin civil, nuk kanë patur asnjë pretendim dhe kane kerkuar ta zgjidhin konfliktin për pasojat, si gjate procesit civil edhe penal.Per kete pasuri vete Gjykatat Civile kanë kryer akt ekspertime të ndryshme pasi është dashur mendimi i specializuar se ku ndodhet prona e familjes K..

Pra sa me larte ,gjykata cmon se të pandehurit në asnje raste nuk kanë patur qellim të marrin pasurine e viktimave ta shesinate me qëllim pastrimi produkti ,pasi të pandehurit si subjekte aktive te veprës penale nuk ka qene te vetëdijshëm, pra, të ketë pasur dijeni se sjellja e tyre ka përbërë një rrezik për shoqërinë , apo me dashje nuk ka respektuar parashikimin ligjor që ndalon kryerjen e veprës penale.

Dijenja dhe qëllimi, parashikohen dhe nxirren nga rrethana fakti objektive. Ky mund të jetë një nga elementët më të vështirë për t'u përcaktuar. Në interpretim të nenit 287 të Kodit

Penal, dijenia e subjektit për origjinën kriminale të produkteve të cilët përbëjnë objektin të veprës penale, nxirret jo vetëm nga provat direkte por edhe nga ato jo të drejtpërdrejta. Kështu, në plotësim të këtij elementi ,gjkata çmon se te pandehurit nuk kane vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi vetë dinamika e ndjekur për vertetimin e pasurisë objekte gjykimi,perfshirja e Gjykates Civile në disa raste,kryerja e disa akte ekspertime topografike se ku ndodhej pasuria, nuk tregojne dijeni dhe qëllimin për cfarë pretendon akuza.

Në lidhje me masën e sigurimit pasuror gjykata cmon se ligji nuk parashikon një definicion në raste të tilla por në intepretim të normave procedural penale, ne raste te pafajsisë gjykata cmon se duhet të deklarohet heqja e mases së sigurimit pasurorë: “Sekuestros preventive” dhene me vendimin Nr.2293 Akti, date 13.10.2018 të Gjykates së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Lidhur me shpenzimet proceduriale.

-Në bazë dhe për zbatim të nenit 393 paragrafi 1 dhe 485 të Kodit të Procedurës Penale shpenzimet proçeduriale hetimore e gjyqesore, ne ngarkim të Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë e provat shkresore të ndodhura në dosje, pjesë përbërëse e pandarë e fashikullit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Në veshtrim te nenit 388 te K.Pr.Penale,Gjkata:

V E N D O S I:

-Te deklaroje te pafajshem te pandehuren A. Z., per vepren penale te “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” te parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

-Te deklaroje te pafajshem te pandehurin G.R., per vepren penale te “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” te parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

-Te deklaroje te pafajshem te pandehurin G. R., per vepren penale te “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” te parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal.

-Deklarimin e heqjes se mases se sigurimit pasuror “Sekuestros preventive” dhene me vendimin Nr.2293 Akti, date 13.10.2018 të Gjykates së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

-Urdherohet oficeri i Policise Gjyqesore per ekzekutimin e ketij vendimi.

-Shpenzimet procedurale hetimore e gjyqesore, ne ngarkim te prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

-Kundër vendimit mund të behet ankim nga palet brenda 15(pesembedhjete) diteve ne Gjykaten e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes se ketij vendimi.Viktimat dhe perfaqesuesi i tyre nuk kane te drejten e ankimit.

-U shpall në Tirane ,sot me date 25.10.2018 .

GJYQTAR
ARTAN GJERMËNI

GJYQTAR
ARBEN MICKAJ

GJYQTAR
ALBERT MECA

SEKRETARE
ORNELA BALLA